

Ismail Shehu është Sekretar i Përgjithshëm që nga 18 mars 2022.

Ai ka lindur më 29 dhjetor në Peshkopi, Dibër dhe ka përfunduar studimet universitare për Drejtësi në Universitetin e Tiranës, në vitin 2008.

Ai ka një karrierë të gjatë në administratën publike ku që nga viti 2008 ka ushtruar detyrat e “Specialistit”, “Përgjegjësit të Sektorit” dhe “Drejtorit” në strukturat juridike të Ministrisë së Mbrojtjes.

Nga viti 2019 deri në vitin 2021 ka mbajtur dhe pozicionin e Kryetarit të Komisionit Ligjor të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Ndërsa nga viti 2021 ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion.

Po ashtu Z. Shehu është përfshirë dhe në botën akademike ku prej 5 vitesh zhvillon trajnime për të gjithë administratën publike pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) në fushën e “Procedurave administrative” si dhe në “Organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Ndër vite është trajnuar në fushat e drejtësisë dhe është *alumni* i Defense Institute of International Legal Studies (DIILS), i tanuar për çështje të Zhvillimit të Legjislacionit dhe Aspektet Ligjore të Luftës Kundër Korrupsionit, si dhe *alumni* i European Fund for the Balkans (EFB) Programi i zhvillimit efikas të administratave publike të Ballkanit Perëndimor.

Që nga viti 2012 është pajisur me licencë avokati nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Flet rrjedhshëm anglisht dhe italisht.

Kontakt: Ismail.Shehu@drejtesia.gov.al